



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONERËT PUBLIKË**

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 4.7.2019

- Kërkesë:** Rivendosje në afat e së drejtës për të ushtruar ankim, kundrejt një shkaku të panjohur më parë
- Kërkues:** Komisioneri Publik Darjel Sina
- Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni B, pika 3, germa “b”, neni C, pika 2, neni Ç, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63, neni 67 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”
- Për kompetencë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese
- Për dijeni:** Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit
- Depozituar pranë:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese  
Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Të nderuar zonja/zotërinj, gjyqtarë të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pranë Gjykatës Kushtetuese,

Komisioneri Publik, më datë 26.10.2018, ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (*referuar në vijim Komisioni*) për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. Ankimi është bazuar referuar gjendjes së fakteve dhe provave të administruara në dosje të Komisionit, përcjellë në format elektronik (CD) në Institucionin e Komisionerëve Publikë, si dhe kundrejt qëndrimit që Komisioni ka mbajtur mbi to.

Në krahasim me kompetencat kushtetuese dhe ligjore që u njihen Komisionit dhe Kolegjit nga neni Ç i aneksit të Kushtetutës, nenet 48-52, të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik është i detyruar që kompetencën e tij, për të ushtruar ankim ndaj vendimeve të Komisionit, ta mbështesë vetëm në aktet dhe provat e administruara dhe të vëna në dispozicion nga ana e këtij të fundit, pa pasur mundësinë ai vetë (Komisioneri), që të ketë akses në burimet e informacionit dhe të disponojë në marrjen e tyre.

Kolegji i Posaçëm i Apelit, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë \*\*\*.6.2019, ka përcjellë pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë dy gjetje të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, të depozituara nga ky i fundit pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, që lidhen me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit.

Gjetja e parë, përcjellë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, me shkresën nr.\*\*\* prot. ONM, datë 15.11.2018, lidhet me informacione/denoncime të dërguara pranë Komisionit pas dhënies së vendimit nr. 62/2018, të cilat vlerësojmë se do të shqyrtohen nga Kolegji sipas nenit Ç, pika 2, të aneksit të Kushtetutës dhe nenit 53 të ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me këto informacione/denoncime, Komisioneri Publik çmon se do të trajtohen nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit, nisur dhe nga fakti se në jurisprudencën e tij (vendimet (JR) nr. 4/2018 dhe 3/2019) ka konsideruar të mundshëm vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve, edhe në një situatë konkrete ku shkarkimi nga detyra bazohet në një kriter të vetëm, në funksion të garantimit të funksionimit të shtetit të së drejtës dhe rikthimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.

Gjetja e dytë, përcjellë pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, me shkresën nr.\*\*\* ex'18 ONM, datë 20.6.2019, lidhet me një fakt për të cilin Komisioneri Publik nuk ka qenë në dijeni. Gjetja i referohet dy dokumenteve, konkretisht: (1) dokument i datës 6.6.2019, vënë në dispozicion të ONM-së nga relatori i çështjes i trupit gjykues të Komisionit, që paraqet një analizë financiare të paqartë, nëse është në versionin përfundimtar; (2) dokument i arkivit digjital i ONM-së, vënë në dispozicion kësaj të fundit më datë 22.5.2018, që paraqet një version tjetër të analizës financiare nga ajo e pasqyruar në dokumentin (1). Këto dy dokumente së bashku me shënimin e numërtuar 10, “Nga analiza financiare e bërë”, në vendimin nr. 62/2018, dëshmojnë faktin që Komisioni ka realizuar dhe përdorur një analizë financiare në funksion të vlerësimit të kriterit të pasurisë, e cila nuk është pjesë e akteve në dosjen e përcjellë pranë Komisionerit Publik.

Ankimi i Komisionerit Publik, i datës 26.10.2018, është bazuar në aktet dhe provat e administruara në dosjen e Komisionit, ku mungojnë dokumentet (1) dhe (2), të cilat paraqesin rrethana të rëndësishme për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe përbëjnë fakte dhe prova të reja në kuptim kjo dhe të nenit 47, të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, të ndryshuar.

Në këto kushte, në mbështetje të nenit 67, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë rivendosjen në afat të së drejtës për të ushtruar ankim kundrejt një shkaku të panjohur më parë nga ana e Komisionerit Publik, për vlerësimin e kriterit të pasurisë në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, neneve 30-34, të ligjit nr. 84/2016, në funksion kjo dhe të ankimit të ushtruar kundrejt vendimit nr. 62/2018.

Të dyja kërkesat ligjore të nenit 67, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit, në rastin konkret përmbushen për sa vijon:

1. Plotësohet kërkesa për paraqitjen brenda afatit ligjor 15-ditor nga data që jemi vënë në dijeni për shkakun e humbur, konkretisht faktet e reja sa më lart trajtuar, dokumentet (1) dhe (2);

2. Plotësohet kërkesa për shkakun legjitim dhe të arsyeshëm, pasi Komisioneri Publik, në momentin e paraqitjes së ankimit të datës 26.10.2018, nuk ka qenë në dijeni të fakteve, dokumenteve (1) dhe (2), të cilat paraqesin rrethana të rëndësishme për vlerësimin e kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

Bashkëlidhur kësaj kërkesë për rivendosje në afat gjeni: “Ankimin shtesë të Komisionerit Publik për sa i përket rivlerësimit të kriterit pasuror të vendimit nr. 62, datë 3.8.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë”.

## KOMISIONERI PUBLIK

**Darjel SINA**